



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1730 Prot.

Tiranë, më datë 20.12.2021

VENDIM

Nr. 694, datë 20.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknikë dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurim mur rrethues dhe portës\_Varianti Nr. 1”, brenda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Gjirokastrës, me aplikues dhe projektues të licencuar në ndërhyrje në pasuri kulturore z. Jorgo Xuhano dhe zhvillues z. Vladimir Jani;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkruara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknikë në IKTK;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknikë për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Rudina ZOTO

